



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 02.11.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Përfundimit nr.06-75711-23/2 të miratuar me dt: 23.10.2015 në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, me të cilin është miratuar kërkesa e OJQ “Thirrjet e Nënave” për ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve të mirëmbajtjes së objektit “Shtëpia e Muzeut Historik 1999-Shtëpia tradicionale e familjes Qerkezi”, me dt: 02.11.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e OJQ “Thirrjet e Nënave” nr. 01-400-74637 e dt. 19.10.2015 për subvencionimin e shpenzimeve për funksionimin dhe mirëmbajtjen “Shtëpisë së Muzeut Historik 1999-Shtëpia tradicionale e familjes Qerkezi”, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në vlerë prej 1,810.00€.
2. Sigurimi i kompjuterit dhe printerit për mbarëvajtjen e punës në objektin “Shtëpia e Muzeut Historik 1999-Shtëpia tradicionale e familjes Qerkezi”, do të bëhet nga Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative.
3. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 1,810.00€ nga mjetet e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e OJQ “Thirrjet e Nënave”, nr. 1140087753000125 Procredit Bank.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Vendimi iu dërgohet:
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
 - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
 - Znj. Nesrete Kumnova, kryetare e OJQ “Thirrjet e Nënave”, Gjakovë
 - Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila